

VENDIM
Nr. 785, datë 22.11.2006

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË STRUKTURËS E
TË NIVELIT TË PAGAVE TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË KONTABILITETIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 445, datë 13.7.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Struktura organizative e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Organika e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të administratës së Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr. 3, diplomë e shkollës së lartë, të jetë 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë në muaj.
 5. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2) e lidhjes nr.3 të jetë në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
 6. Shtesa për kualifikim (kolona 3) e lidhjes nr.3, të jetë 0.
 7. Shtesa për pozicion të jetë sipas kolonës 4 të lidhjes nr.3.
 8. Paga për pozicionin “Sekretar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit” të jetë 35 900 lekë në muaj. Shtesa për vjetërsi në punë, për punonjës në këtë pozicion, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 10 050 lekë.
 9. Numri i punonjësve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë, gjithsej, 5 veta.
 10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e miratuara për Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT



Lidhja nr.2

ORGANIKA E ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Pozicioni	Numri
Drejtor ekzekutiv	1
Inspektor (për standardet ndërkombëtare të kontabilitetit)	1
Inspektor (për standardet kombëtare të kontabilitetit)	1
Sekretar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit	1
Specialist (financë, arkiv)	1
Punonjës gjithsej	5

(Ndryshuar me VKM nr. 445, datë 13.7.2007)

LIDHJA NR. 3

Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve të administratës së Këshillit
Kombëtar të Kontabilitetit

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Drejt看 ekzekutiv.	II-b	10.050	2%	0	84.000
Inspektor	III-a	10.050	2%	0	65.000
Specialist.	IV-b	10.050	2%	0	25.850